



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUÇITRAN

01 Nr. / Br. 157/22

Nr. i fq. / Br. st. -3-

Data: / Datum 30.06.2022

VUÇITRAN - VUÇITRAN



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI

RREGULLORE
(KKV) NR.01/2022 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
RREGULLORES (KKV) NR.03/2020 PËR PËRKRAHJEN E FERMERËVE
NË BUJQËSI DHE BIZNESEVE NË SEKTORIN PRIVAT

Qershor, 2022

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja “c” të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 e datës 4 qershor 2008”; neni 17, paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.27 e datës 3 qershor 2018”, neni 36, paragrafi 3 i Rregullores financiare Nr.01/2013 e datës 25 gusht 2013 të MF Shpenzimi i parave publike si dhe nenin 40, paragrafi 2, shkronja “a” të Statutit të komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **30 qershor 2022** miraton këtë:

**RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES (KKV) NR.03/2020 PËR
PËRKRAHJEN E FERMERËVE NË BUJQËSI DHE BIZNESEVE NË SEKTORIN
PRIVAT**

Neni 1

Me këtë rregullore ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja (KKV) nr.03/20 datë 27.2.2020, për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat.

Neni 2

Pika 1.1 e nenit 2 riformulohet si në vijim:

Subvencionet dhe grantet- përfshijnë të gjitha transferet e njëanshme, të pakthyeshme në formën e pajisjeve dhe makinave, serra, material fidanor për pemë e perime, bagëti, shpezë, bletë, farëra të llojeve të ndryshme e repromaterial tjetër për individë dhe biznese, si dhe përkrahje me mjete financiare.

Neni 3

Pika 4 e nenit 5 hiqet.

Neni 4

Pika 2 e nenit 6 riformulohet si në vijim:

Personi fizik dhe juridik brenda vitit mund të jetë përfitues i më shumë se një lloji të grantit apo subvencionit nëse i plotëson kushtet specifike të thirrjes.

Neni 5

Pika 4 e nenit 8 riformulohet si në vijim:

Përbërja e komisionit duhet të jetë prej 3 anëtarëve.

Neni 6

Pika 3 e nenit 9 riformulohet si në vijim:
Komisioni do të jetë në përbërje prej 3 anëtarëve.

Neni 7

Pika 1 e nenit 11 riformulohet si në vijim:
Brenda shtatë (7) ditë pune nga data e mbylljes së thirrjes publike, komisioni vlerësues bënë hapjen e çdo aplikacioni, nëse ato i plotësojnë kriteret formale, duke përfshirë kriteret e paraqitura në këtë rregullore.

Neni 8

Pika 1 e nenit 12 riformulohet si në vijim:
Komisioni pas vlerësimit të aplikacioneve në aspektin procedural vazhdon menjëherë me shqyrtimin e aplikacioneve dhe atë jo më gjatë se katërmëdhjetë (14) ditë pune, nga dita e përfundimit të afatit të aplikimit në shpalljen publike.

Neni 9

Pika 6 e nenit 12 hiqet.

Neni 10

Pika 2 e nenit 13 riformulohet si në vijim:
Në afat prej 5 ditëve të punës palët e pakënaqura me shkrim i drejtohen komisionit të ankesave për ndarjen e subvencioneve.

Neni 11

Pika 4 e nenit 13 riformulohet si në vijim:
Në këtë fazë komisioni i ankesave kërkon nga komisioni i vlerësimit të aplikacioneve listën e aplikuesve së bashku me dokumentacionin e tyre.

Neni 12

Neni 16 hiqet.

Neni 13

Pikat tjera të rregullores bazë mbesin të pandryshuara.

Neni 14

Për zbatimin e kësaj rregulloreje obligohet: Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Neni 15

Kjo rregullore hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli -Latifi

Kryesuese e Kuvendit

